

RELACION SHPJEGUES

**I PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 53/2019,
DATË 18.07.2019 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË””**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është korigjimi i bazave juridike të ligjit ekzistues, nr.53/2019 për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave.

Objektivat e projektligjit kanë të bëjnë me “*përbërjen dhe detyrat e Asamblesë*”, si organ i zgjedhur i Akademisë, me “*zgjedhjen e Kryesisë*”, si organ ekzekutiv i sajë, me “*vlefshmërinë dhe ndërprerjen e mandateve*”, si dhe me “Dispozitat e fundit” për “*Administratën e Akademisë*”, që lidhet me “*Strukturën, organikën dhe nivelin e pagave për administratën e Akademisë*”.

Përmirësimet ligjore të propozuara kanë të bëjnë me ndërtimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit si edhe nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore e praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe kuadrin ligjor në fuqi “Ligin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji vlerësohet si pjesë integrale e programit qeverisës në vazhdimësi, si edhe në këtë qeverisjeje 2021/2025, e materializuar në vetë qëllimin e këtij projektligji i cili para së gjithash ka në fokus disa shtesa dhe ndryshime të ligjit ekzistues, nr.53/2019 për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave, me synim unifikimin dhe partneritetin me vëndet e Bashkimit Evropian dhe ato rajonal, transfuzionin e standardeve dhe praktikave më të mira europiane, si dhe parimet e veprimtarisë shkencore europiane.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj, me disa shtesa dhe ndryshime, vjenë pas një periudhe trevjeçare e gjysmë nga hyrja në fuqi e Ligjit ekzistues, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, kohë e plotë maturimi për përmirësimë të nevojshëme.

Ligjet ekzistues, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave” është hartuar në përgjigje të kërkimesave të drejta të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, por edhe të komunitetit akademik e shkencor të vendit si dhe interesit publik për të ndërtuar një Akademi të Shkencave sipas modeleve më të suksesshme bashkëkohore.

Ky ligj, ridimensionoj dhe ripërcaktoj funksionet e Akademisë së Shkencave, duke theksuar rolin këshillimor, rekomandues, promovues, botues, nxitës, bashkëpunues dhe bashkërendues të saj në sistemin e kërkimit shkencor të vendit.

Ky ligj, realizojë ripërtëritjen e Akademisë së Shkencave dhe të përbërjes së saj me përfaqësues nga më të shquarit të komuniteteve shkencore të vendit, nëpërmjet harmonizimit të brezave, moshave e fushave të kërkimit, vendosi kriterë më rigorozë e të matshme për pranimin e anëtarëve të rinj si edhe vendos si kufi pranimi për anëtarët e rinj të Akademisë moshën 65 vjeç.

Gjithashtu, ligji nuk përfshin më kategorinë e akademikut të pérhershëm, duke iu dhënë akademikëve mbi 75 vjeç statusin Emeritus dhe duke i çliruar ata nga disa detyrime institucionale të pjesëmarrjes në veprimtarinë e Akademisë.

Ligji i ri formalizoj funksionimin e Akademisë së të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë së Shkencave, me synimin për të inkurajuar drejtpërsëdrejti veprimtarinë kërkimore shkencore të kërkuesve të rinj dhe përvendosjen e një ure komunikimi e promovimi me ta.

Me ligjin e ri për Akademinë e Shkencave, u krijuan kushtet ligjore për demokratizimin e funksionimit të Akademisë së Shkencave, duke harmonizuar vendimmarrjen e organeve ekzekutive më atë të Asamblesë dhe sektioneve, si edhe duke përcaktuar qartë kompetencat, funksionet dhe procedurat vendimmarrëse.

Gjithashtu ligji i ri kufizoi mandatet e drejtuesve të zgjedhur të Akademisë deri në dy, duke krijuar kushtet për ripërtëritjen edhe të drejtuesve të Akademisë.

Ligji i ri ndërtojë një Akademi të Shkencave të hapur drejt komuniteteve të arsimit të lartë dhe atyre kërkimore të vendit. Kjo u realizua nëpërmjet ndërtimit të komisioneve, si njësi permanente të Akademisë, në kuadrin e sektioneve, dhe të përbëra, përvèç se nga anëtarët e Akademisë, edhe nga profesorë dhe ekspertë të kualifikuar të të gjitha fushave dhe me arritje të spikatura në disiplinat përkatëse.

Qendra e gravitetit të veprimtarisë së Akademisë është zhvendosur tashmë nga Kryesia, drejt Asamblesë, sektioneve e komisioneve.

Gjithashtu, integriteti i Akademisë dhe i akademikëve është i garantuar edhe nga përcaktimet ligjore të qarta mbi vlefshmérinë, papajtueshméritë dhe ndërprerjen e mandateve të akademikëve e drejtuesve të Akademisë.

Ligji i ri krijoj kushtet ligjore që funksionimi i Akademisë së Shkencave dhe veprimtaria e saj të hapen e sinkronizohen me veprimtarinë e Akademive dhe akademikëve shqiptarë jashtë Shqipërisë. Një dispozitë e veçante e tij parashikon që personat me shtetësi shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të ALLEA-s, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ligji i ri mundësojë sinergjinë midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtarëve të saj me akademikët shqiptarë në vendet e rajonit dhe në Diasporë, për trajtimin në mënyrë më të institucionalizuar e më të koordinuar të problematikave shkencore mbarëkombëtare.

Në vijim po citoj disa nga arritjet e Akademisë së Shkencave pas miratimit të Ligjit nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”:

1. Trupa akademike:

- Iu rikthyte autoriteti Asamblesë ekzistuese, me kthimin e së drejtës së votës anëtarëve mbi 75 vjeç, të cilët ishin privuar nga kjo e drejtë në vitin 2007.
- U hapën fushat dhe u bënë dy herë pranime anëtarësh të rindje me titull “akademik” e “akademik i asociauar”, me procedurë të ligjshme. Në proces pranime për katër fusha të reja.
- U rivendos ekuilibri midis shkencave shoqërore-albanologjike dhe atyre natyrore-teknike (sot 26 me 27, duke përfshirë anëtarët me votë të detyruar dhe ata me pjesemarrje në votim sipas vullnetit të tyre.
- U bënë pranime të reja për titullin “anëtarë të jashtëm” të personaliteteve më të shquar shqiptarë me qëndrim jashtë vendit, duke vendsur urat midis intelektualeve shqiptarë brenda e jashtë vendit.
- U bënë pranime të anëtarëve të nderit nga radhët e albanologëve më të shquar të huaj.
- U nderuan intelektualët më të njohur të vendit që për arsyet kufizimeve të moshës nuk mund të konkuronin më për anëtarë të Asamblesë.
- U hartua statuti i ri i Akademisë së të rindjeve.
- U themeluan komisionet e përhershme sipas fushës së ekspertizës me pjesemarrjen në to të dyfishit të anëtarëve të Asamblesë (nga radhët e profesoratit dhe të qëndrave kërkimore).
- U ngriten njësitë e përkohshme të kërkim-studimit përfusha prioritare, që punojnë mbi baza projektesh.
- U ngritën disa qendra kërkimore me statusin e një para-instituti.

- U nënshkruan marreveshje bashkëpunimi thuajse me të gjitha universitetet e vendit dhe universitetet shqiptare në vendet fqinje.
 - U nënshkruan marrëveshje ndërakademike me disa vende, si dhe me universitete ku studiohet albanologjia.
 - Bashkëpunimi me ASHAK-un prioritet mbi prioritetet.
 - U hartuan disa projektligje e akte nënligjore në shërbim të progresit të vendit.
 - U rrit roli i Akademisë në kuadër të federatës europiane të akademive ALLEA dhe të organizatave të tjera.
 - U hartuan e miratuan Statuti i ri dhe gjithë paketa e rregullorëve të punës.
2. U punua me tre projektet madhore: Fjalor i madh i gjuhës shqipe, Histori e shqiptarëve dhe Enciklopedia shqiptare.
 3. Pas 50 vjetesh u organizua Kuvendi Ndërkombetar i Studimeve Albanogjike.
 4. U organizua Kongresi Botëror i Baladave.
 5. U organizuan dy kongrese ndërkombetare të nanoshkences dhe nanoteknologjisë.
 6. U organizuan pesë forume për pandeminë.
 7. U zhvilluan dy kongrese ndërkombëtare për sizmoligjinë dhe dy për bioteknologjinë.
 8. U organizuan tri veprimitari ndërkombëtare për drejtshkrimin e shqipes dhe u stabilizuan parimet e njesimit të saj.
 9. Çdo vit ka pasur mesatarisht 120-150 veprimitari shkencore e jubilare: forume, simpoziume, konferanca dhe kongrese.
 10. Pjesemarrja mesatare vjetore e referuesve 2000-2500 studiues.
 11. Nuk ka bashkësi kërkimore në vend që të mos ketë vit për vit së paku një veprimtari të përbashkët.
 12. Botohen çdo vit 35-40 tituj veprash shkencore, më shumë se gjysma autorë jashtë Akademisë.
 13. Botimet tona shkojnë në forme koleksioni në të gjitha bibliotekat universitare e ato publike dhe në qëndrat albanogjike të huaja.
 14. Pjesemarrje në projekte europiane (5 këtë vit, 2022).
 15. Këtë vit (2023) në Tirane mbahet samiti ndërakademik i Ballkanit Perendimor, vlerësim i Akademisë Leopoldina, që ndjek Procesin e Berlinit.
 16. Pranimet e reja bëhen me aktivizimin statutor të Senateve Akademike në Universitete, ku nis promovimi i kandidaturave.

Për sa më sipër, pas maturimit trevjeçar e gjysmë të “Ligjit, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, aktualisht në veprimtarinë e Akademisë së Shkencave, ka lindur nevoja e përmirësimeve të domosdoshëme që janë propozuar nëpërmjet këtij projektligji, i cili nuk prek thelbin dhe përbajtjen e ligjit bazë, por korigon disa dispozita parazitare, si dhe bënë plotësime dhe saktësime që kanë të bëjnë me “*përbërjen dhe detyrat e Asamblesë*”, si organ i zgjedhur i Akademisë, me “*zgjedhjen e Kryesisë*”, si organ ekzekutiv i sajë, me “*vlefshmërinë dhe ndërpërjen e mandateve*”, si dhe me “*Dispozitat e*

fundit” që lidhen me “*Strukturën, organikën dhe nivelin e pagave për Administratën e Akademisë*”.

Këto shtesa dhe ndryshime ligjore kolaudojnë pozitivisht ndërtimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit si edhe nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore e praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor në vend.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, posaçërisht nenin 58, i cili garanton se liria e kërkimit shkencor mbrohet me ligj, dhe nenin 59, i cili përcakton se shteti synon mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Projektligji është në përputhje të plotë si dhe me të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi, përfshirë nevojën e përputhshmërisë dhe harmonizimin teknik me projektligjin për shkencën dhe për arsimin e lartë, për të cilat do të bëhen ndryshimet përkatëse.

Projektligji është në sinergji e sintoni me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ligjin për shkencën, si edhe legjislacionin për kërkimin shkencor në proces përgatitjeje.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE BE

Projektligji reflekton standarde taret përmes praktikave më të mira europiane, si dhe parimet e veprimtarisë shkencore europiane, çka konfirmohet qartazi nga vlerësimet e ALLEA-s, gjatë hartimit të ligjit bazë.

Projektligji është në përputhje të plotë me standartet ALLEA-All European Academies (Shoqata e Akademive Europiane), në të cilën është anëtare edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Projektligji është në përputhje edhe me kërkesat e Kodit European të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, 2017.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Për arritjen e qëllimit të lartpërmendur, projektligji propozon disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

Neni 1, riformulon pikën 3, të nenit 6, ku hiqen fjalët: “i anëtarëve të jashtëm deri në 10 dhe i anëtarëve korrespondente deri ne 15”, si dhe “Këta të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e kufirit maksimal të sipërcituar”.

Nëpërmjet këtij riformulimi hiqet koncepti i antarit korrespondent pasi është ekujivalent me antarin e jashtëm, duke shmangur edhe një konfuzion në përcaktimet “i jashtëm” e “korrespondent”.

Propozohet të hiqet ky kufizimi për anëtarët e jashtëm për të mundësuar një zgjerim të anëtarësisë me anëtarë të jashtëm nga diaspora jonë, personalitete dhe kërkues të suksesshëm.

Neni 2, riformulon nenin 10, ku hiqen fjalët: “anëtarëve korrespondente”, si dhe shtohet togfjalshi “pa të drejtë vote”.

Nëpërmjet këtij riformulimi përcaktohet edhe statusi i anëtarëve të jashtëm dhe atyre të nderit, për të shmangur çdo paqartësi lidhur me të drejtën e votimit

Neni 3, riformulon pikën 3 dhe 4 të nenit 11, si dhe pika 11 e nenit 11, bëhet pika 1.

Pika 4, e nenit 11, riformulohet si bashkim i pikës 8 dhe 9 duke shtuar në fillim të fjalisë së parë, togfjalshin “*Kryetari dhe*”, si dhe hiqet nga fjalia e dytë, togfjalshi “por jo radhazi”.

Neni 4, në pikën 4, nenit 14, hiqet fala “korrespondent”, dhe zvendësohet me fjalën “i jashtëm”.

Neni 5, në pikën 2, neni 16, që lidhet me “ndërprerjen e mandateve”, hiqet gërma “c”, ndërsa pika “ç” bëhet “c”.

Nëpërmjet këtij ndryshimi, harmonizohet statusi i anëtarit “Emeritues” në përputhje me Nenin 6, pikat 1 dhe 4 të këtij ligji.

Neni 6, në ninen 22, që lidhet me “Dispozitat e fundit” për “Administratën”, pas pikws 5, *shtohet pika 6*, me këtë *përbajtje*:

“6. Pagat e anëtarëve të Kryesisë janë sipas tabelës bashkëngjitur këtij projektligji, ndërsa për punonjësit dhe drejtuesit shkencorë joadministrativ, si dhe të atyre të njësive të kërkim-studimit përcaktohen sipas nenit 19, pika 3 dhe 4, të këtij ligji.”

Argumenti për shtimin e pikës 6 është i thjeshtë, pasi ligji ekzistues nuk flet për pagat e Kryesisë dhe për pjesën e punonjësve jo administratë, pra atë që në e quajmë drejtim shkencorë.

Struktura e Akademisë përbëhet nga drejtimi shkencor dhe administrata formale, me këtë poropozim zgjidhen dy gjëra: plotësohet një vakum ligjorë dhe i jepet liri Akademisë për drejtimin shkencor.

Neni 7, ka të bëjë me hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Projektligji ngarkon për zbatimin e tij Këshillin e Ministrave, ministrinë përgjegjëse për shkencën, ministrinë përgjegjëse për financat, Akademinë e Shkencave, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore, organizatat dhe shoqatat e dijes, si dhe kërkuesit që kryejnë kërkim publik e privat, organet e tjera të lidhura me veprimtarinë akademike e kërkimore të cilët zhvillojnë dhe mbajnë përgjegjësitë e veta në procesin e kërkimit shkencor.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Projektligji nuk sjell si pasojë rritje të shpenzimeve buxhetore për Akademinë e Shkencave, as për institucionet e tjera.

VENDIM
Nr. 36/2020

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE NIVELIT TË PAGAVE
PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 2/a, të ligjit nr. 10 405 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” dhe nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën Shqipërisë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 9.7.2020.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA**

**STRUKTURA, ORGANIKA DHE NIVELI I PAGAVE I AKADEMISË SË
SHKENCAVE**

DREJTIMI INSTITUCIONAL SHKENCOR

		Numri	Kategoria
	KRYESIA	4	
	Kryetar	1	C (0.68)
	Zëvendëskryetar	1	D (0.6)
	Sekretar shkencor	1	D (0.6)
	Sekretare e Kryesise	1	III-b
	SEKSIONET SHKENCORE	4	
	Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjë (anëtar Kryesie)	1	E (0.55)
	Sekretar teknik i SSHSHA-së	1	IV-a
	Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike (anëtar Kryesie)	1	E (0.55)
	Sekretar teknik i SSHTN-së	1	IV-a
	QENDRA E PROJEKTEVE DHE KOORDINIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR	4	
	- Drejtore	1	II-b
	- Koordinator kërkimor-shkencor	3	III-b

ADMINISTRATA

KANCELARI	1	I-b
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN	2	
- Specialist për burimet njerëzore	1	III-b
- Specialist për marrëdhëniet me jashtë	1	IV-a
SEKTORI I BOTIMEVE SHKENCORE	6	
- Përgjegjës sektori	1	III-a1
- Redaktor shkencor	1	III-b
- Redaktor shkencor	1	III-b
- Bibliografe	1	IV-a
- Bibliotekare	1	IV-a
- Editor botimesh	1	Kl. VI
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS	4	
- Përgjegjës sektori	1	III-a1

- Specialist finance	1	IV-a
- Specialist për shpërndarjen e librit akademik	1	IV-b
- Magazinier/ shofer	1	Kl. VI
SEKTORI NDIHMËS		
- Shofer	1	Kl. IV
- Punëtor mirëmbajtës	1	Kl. IV
- Punonjës pastrimi	1	Kl. I
- Arkivist-protokollist	1	Kl. VII
TOTALI	29	